



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1266/1 prot.

Tiranë, më 15.11.2021

V E N D I M

Nr. 217 , datë 15 . 11.2021

Mbështetur në nenin 32/1/c, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar dhe bazuar në informacionin e marrë gjatë transmetimit të emisionit “Zonë e Lirë”, të datës 18.06.2021, në TV Klan dhe emisionit “Ndryshe”, të datës 22.06.2021, transmetuar në Top Albania Radio, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vijim Komisioneri), filloi procedurat hetimore për ndjekjen kryesisht të çështjes, në lidhje me deklaratat e A.P, mbi komunitetin LGBTI, të bëra në këto media.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve.

Në përmbushje të misionit të tij dhe në ushtrim të kompetencave të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri monitoron transmetimet e ndryshme në media, me qëllim që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Në këtë kontekst, Komisioneri ka monitoruar emisionin “Zonë e Lirë”, të datës 18.06.2021, transmetuar në TV Klan dhe emisionin “Ndryshe”, të datës 22.06.2021, transmetuar në Top Albania Radio, pas sinjalizimeve të ardhura nga qytetarë dhe organizata të shoqërisë civile.

Referuar informacionit të marrë gjatë transmetimit të emisionit “Zonë e Lirë”, të datës 18.06.2021, në TV Klan, rezulton se, një nga temat e diskutuara dhe ku ka qenë i ftuar A.P, lidhej me shpalljen nongrata të personave homofobë¹. Gjatë diskutimit të zhvilluar në këtë emision, rezulton se ndër të tjera A.P është shprehur se: “.....gej Shqiptar apo Anglez apo Skocez, Britanik apo nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të jesh gej është gej, është devijancë, është të dalësh nga rruga.....Nuk ka akt më të shëmtuar dhe nuk ka akt më skandaloz se sa të kërkohet dehumanizimi i qënieve njerëzore, duke i vendosur një numër. E dini se çfarë më kujton

¹ Shiko: <https://www.youtube.com/watch?v=-SZ4CfEQWxg>

kjo ideja e heqjes së fjalës nënë dhe fjalës baba, por vendosja e një numri, prindi 1 dhe prindi 2?..... Kampet e përqëndrimit të Hitlerit, një numër social që z. Ilirjani e njeh fare mirë në SHBA, numrat e të burgosurve.....”

Më tej gjatë zhvillimit të diskutimeve, A.P, ka vazhduar fjalën tij, duke u shprehur se: “..... Nuk ka çnderim më të madh se sa të heqësh nocionin nënë dhe t’i vendosësh një numër. Pastaj dhe me hapjen e kërkesës të të drejtës tjetër që këta duan të fitojnë, dhe e drejta tjetër është adoptimi i fëmijëve. Dhe hyjmë tek një akt skandaloz kriminal. I heq të drejtën një fëmije të vogël për të patur një nënë dhe një baba, duke i mundësuar atij të jetojë me dy burra ose me dy gra.....Imagjioni ato foshnje të vogla të cilave do t’ju hiqet e drejta përmes adoptimit dhe duke u adoptuar nga çifte homoseksuale që mund të jenë dy burra, hiqet e drejta për të patur një nënë. Shiko sa i skajshëm është ky egoizëm etik që e quan Aristoteli. Pra, dashuria e këtyre individëve për veten e tyre, bën që të shkelin nënën, babain dhe që të shkelin të drejtat e tyre njerëzore të mbrojtura nga karta e të drejtave njerëzore mbi fëmijët...”

Referuar informacionit të marrë gjatë transmetimit të emisionit “Ndryshe”, të datës 22.06.2021, transmetuar në Top Albania Radio, rezulton se A.P, ka qenë i ftuar dhe ka diskutuar ndër të tjera për komunitetin LGBTI dhe kërkesat e tyre². Gjatë transmetimit të këtij emisioni rezulton se midis të tjerave, A.P është shprehur: “të jesh gej është bërë trend.....zëvendësimi nga nëna me prindi 1 dhe nga babai me prindin 2, së pari kemi të bëjmë me një dekonstrukcion të nocioneve dhe vlerave.....Në këtë moment nëse ne themi do të pranohet në Shqipëri ndryshimi i këtyre nocioneve kaq të rëndësishme për njerëzit, atëherë kjo do t’i hapi rrugën edhe vijimin e kërkesave të tjera të komunitetit LGBTIQ që lidhen me martesën gej, adoptimin e fëmijëve, pastaj unë besoj që kemi të bëjmë edhe me akte kriminale. Kështu i shikoj unë. Akte që lidhen me idenë e mohimit të së drejtës natyrore të një fëmije që të ketë një nënë dhe një baba. Pra një fëmijë do të rritet nga 2 baballarë, duke i’u hequr e drejta për të patur një nënë, apo të rritet nga 2 gra, duke i’u hequr e drejta për të patur një baba.....”.

Në vijim të diskutimeve gjatë këtij emisioni, A.P shprehet: “.....pozicioni im është kundër gjuhës së dhunës përkundrejt komunitetit LGBTIQ. Natyrisht që ne i duam këta njerëz, por nga ana tjetër duhet të jemi të kujdesshëm që të mos shantazhohemi nga mesazhet që përcillen prej këtij komuniteti. Kam dëgjuar që disa figura publike do i padisin në Amerikë për homofobi prej opinionit të tyre. Unë i bie me deklarat e mia të jem homofobi i parë shqiptar.....”, duke vijuar me tej: “.....Me legalizimin e martesave hiqet steka morale. Që do të thotë që çdo njeri mund të vijë dhe të kërkojë martesën dhe me një kafshë, mund të kërkojë edhe martesën treshe, katërshe....Nuk ka më kufi.....”

Pjesë nga diskutimi gjatë emisionit “Ndryshe”, është postuar nga Top Albania Radio në faqen e saj të internetit³ dhe në rrjetin social Instagram⁴.

² Shiko : <https://www.youtube.com/watch?v=kdRwVCDusoE>

³Shiko: <https://www.topalbaniaradio.com/v7/pastor-a-p-kerkesat-e-komunitetit-lgbtqi-i-konsideroj-akte-kriminale/>

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e çështjes nga Komisioneri.

Në ushtrim të kompetencës së parashikuar nga neni 33/1/c të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, e cila i jep të drejtën Komisionerit që të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji, Komisioneri me urdhrin nr. 91, datë 24.06.2021, urdhëroi fillimin e procedurave hetimore për ndjekjen kryesisht të çështjes, në lidhje me deklaratat e bëra në mediat e sipërcituara nga A.P për komunitetin LGBTI.

Hapat procedurialë të ndjekur nga Komisioneri për shqyrtimin e çështjes, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Me shkresën nr. 968/1 prot., datë 30.06.2021, Komisioneri njoftoi A.P për fillimin e procedurës administrative në ngarkim të tij dhe njëkohësisht kërkoi parashtrimet e tij në lidhje me çështjen. Përveç dërgimit nëpërmjet shërbimit postar, njoftimi i mësipërm i është njoftuar subjektit në datën 01.07.2021 edhe nëpërmjet adresës së e-mail [XXXXXXXXXXXXXX](#).

Komisioneri evidenton se, i gjithë komunikimi me subjektin është realizuar në rrugë elektronike nëpërmjet adresës së mësipërme të e-mail, pasi subjekti nuk vendosi në dispozicion një adresë të saktë nëpërmjet të cilës të kryeje dorëzimi i njoftimeve në rrugë postare. Rezultoi se njoftimet e dërguara nëpërmjet shërbimit postar në adresat që ishin vendosur nga vetë subjekti në korrespondencën e tij janë kthyer mbrapsh me shënime si “refuzuar” ose “ka ndërruar adresë”. Me e-mail-in e datës 09.07.2021, ankuesi theksoi se, nuk ka refuzuar asnjë dokument të dërguar nga Komisioneri nëpërmjet shërbimit postar, por nuk i’u përgjigj kërkesës së Komisionerit për të vendosur në dispozicion një adresë të saktë në të cilën të dërgoheshin njoftimet nëpërmjet shërbimit postar. Nga ana tjetër, rezulton e provuar se, njoftimet e realizuara në rrugë elektronike janë marrë nga subjekti i cili ka kthyer edhe përgjigjet përkatëse. Gjithashtu ligji nuk parashikon ndonjë formë tjetër të detyrueshme njoftimi.

2. Me e-mail-it datë 02.07.2021, A.P ka dërguar një kërkesë paraprake proceduriale, nëpërmjet të cilës ka kërkuar kopje të vendimit të nisjes së hetimit të ndërmarrë kryesisht nga Komisioneri së bashku me provat, në formën e kërkuar nga ligji.
3. Me shkresën nr. 968/2 prot., datë 05.07.2021, e cila iu komunikua subjektit në rrugë elektronike, Komisioneri vuri në dispozicion të subjektit kopje të urdhrin nr. 91, datë 24.06.2021.
4. Me e-mail-in datë 12.07.2021, A.P ka dërguar parashtrimet në lidhje me çështjet. Subjekti ka dërguar parashtrimet edhe në rrugë postare, të cilat janë administruar pranë Komisionerit me nr. 968/4 prot., datë 14.07.2021.

⁴Shiko: https://www.instagram.com/p/CQboYzCrRBh/?utm_medium=copy_link&fbclid=IwAR2tIn0YAhiDU-FxMQCglqOKMiSZrFwTSgoMcGFhow0kHg3LerJknD56vNk

Përmbledhtazi, parashtrimet e A.P janë si vijon:

Subjekti pretendon se, transkriptimi është i copëtuar, montuar, se është veçuar qëndrimi i tij, duke e shkëputur tërësisht nga konteksti i asaj që është thënë, duke mos transkriptuar të plotë gjithë qëndrimin tij në emisionet në të cilat ka qenë pjesëmarrës, si Pastor, si klerik, si përfaqësues i doktrinës krishtere. Qëndrimi i shprehur është tërësisht i bazuar në besimin e tij të krishterë dhe se përgjigjet për pyetjet që i janë drejtuar janë të bazuara në doktorinën kishtare, që ai përfaqëson si Pastor. Pra, qëndrimi i tij është i perfrazuar edhe në Bibël.

Subjekti pretendon se, ato që ka thënë, i ka bazuar posaçërisht tek mbrojtja e institucionit të familjes, që besimi i tij i krishterë e ka linjë të filozofizë së saj kishtare, por edhe tek besimi dhe mbrojtja që Kushtetuta jonë detyron shtetin të mbrojë familjen (Neni 53/2) në përputhje me detyrimin e Shqipërisë nga e drejta ndërkombëtare, përfshirë Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Subjekti shprehet se, kurrë nuk ka diskriminuar asnjë njeri, sepse besimi i tij nuk e lejon këtë gjë, por përkundrazi gjithmonë shpalos botëkuptimin e tij, kur pyetet nga mediat, që është plotësisht në përputhje me ligjin dhe mbrohet nga Kushtetuta Republikës së Shqipërisë, neni 24 dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), neni 9 dhe 10. I pyetur në emision nga gazetarët, në lidhje me qëndrimin e tij, subjekti deklaroi se, ka shprehur hapur qëndrimin e tij kishtar, doktrinar, teologjik, Biblik, i cili është i mbrojtur posaçërisht sipas Kushtetutës Shqiptare (neni 24) dhe ligjit ndërkombëtar KEDNJ neni 9 dhe 10.

Subjekti thekson se, asgjë që ai ka thënë nuk ka patur dhe nuk ka qëllim të nxisë urrejtje, për më tepër nuk ka bërë as thirrje të tilla, por përkundrazi, ai shprehet se, nuk urren askënd dhe dëshiron që të gjithë të jetojnë së bashku paqësisht.

Subjekti ngre pretendimin se, po akuzohet për shkak të besimit të tij, për shkak se e shpall këtë besim dhe Biblën. Ai shprehet se përfaqësuesit e Komunitetit LGBTQI+ nuk janë armiq të tij dhe se ka afro 30 vjet që ushtron shërbimin e tij si pastor (klerik/udhëheqës fetar) dhe pothuajse çdo javë përgjatë 13 viteve të fundit e ndan edhe në agorën e debatit publik (televizione dhe radio të ndryshme në vend).

Në të gjitha emisionet televizive dhe në radio, në të cilat ka qenë i ftuar të marrë pjesë në një bisedë apo debat, ku në qendër kanë qenë tema që lidhen me martesën brenda të njëjtës gjini, ndryshimin e nocioneve ‘Mami’ dhe ‘Babi’ dhe zëvendësimi i tyre me ‘Prindi 1’ dhe ‘Prindi 2’, subjekti thekson se ka qenë i ftuar në cilësinë e pastorit (klerikut/udhëheqësit fetar), një të vërtetë të cilën e thekson në programet televizive ku është i pranishëm dhe prej të cilave.

Subjekti pretendon se, nga ana e Komisionerit janë veçuar citime nga komunikimi i tij publik, ndërkohë që komunikimi dhe mesazhet që ka ndarë, janë thelbësisht në esencë dhe përmbajtje pjesë e doktrinës së besimit që zbulohet në Shkrimin e Shenjtë (Bibla).

Në komunikimin publik mbi këto tema, subjekti thekson se, ai nuk shpreh qëndrimin e tij personal, të shkëputur dhe të pambështetur mbi të vërtetën doktrinare të besimit Judeo-Kristian, por ndan qëndrimin Biblik mbi fenomene si, marrëdhëniet brenda të njëjtës gjini, martesat brenda

të njëjtës gjini dhe adoptimin e fëmijëve nga çiftet e cilët i përkasin të njëjtës gjini. Ai thekson se perceptimi i Komisionerit mbi qëndrimin e tij në debatin publik mbi këto tema, nuk mund të jetë i ndarë nga qëndrimi Biblik.

Në vijim të parashtrimeve të tij, subjekti bën një pasqyrë në lidhje me atë që shpall Bibla në lidhje me, raportet intime brenda të njëjtës gjini, çfarë mëson Bibla për martesën dhe çfarë mëson Bibla lidhur me termat “Babi dhe “Mami” përkundrejt termave “Prindi 1” dhe “Prindi 2”, të cilat konsistojnë si vijon :

Çfarë shpall Bibla për raportet intime brenda të njëjtës gjini?

“Në qoftë se Zoti i ushtrive nuk do të na kishte lënë një mbetje të vogël, do të ishim si Sodoma, do t'i ngjishim Gomorrës. Dëgjoni fjalën e Zotit, o krerë të Sodomës, verini veshin ligjit të Perëndisë tonë, o popull i Gomorrës!” Isaia 1:9-10

“Anësia e tyre me personat dëshmon kundër tyre, ata vënë në dukje mëkatet e tyre si Sodoma dhe nuk e fshehin. Mjerë ata, sepse i bëjnë keq vetes së tyre.” Isaia 3:9

“Kështu Babilonia, shkëlqimi i mbretërive, lavdia e krenarisë së Kaldeasve, do të jetë si Sodoma dhe Gomora kur Perëndia i përmbysi.” Isaia 13:19, Jeremia 23:14, 49:17-18, 50:39-40. Ezekieli 16:48-50. Amos 4:1-11, Sofonia 2:9,

Testamentin e Ri.

“Po kështu ndodhi në kohën e Lotit: njerëzit hanin, pinin, blinin, shitnin, mbillnin dhe ndërtonin; por ditën kur Loti doli nga Sodoma, ra shi zjarri e squfuri nga qielli dhe i zhduku të gjithë.” Luka 17:28-29

“Prandaj Perëndia i dorëzoi ata në pasioneve të ulëta, sepse edhe gratë e tyre i shndërruan marrëdhëniet natyrore në atë që është kundër natyrës. Në të njëjtën mënyrë burrat, duke lënë marrëdhëniet e natyrshme me gruan, u ndezën në epshin e tyre për njëri-tjetrin, duke kryer akte të pandershme burra me burra, duke marrë në vetvete shpagimin e duhur për gabimin e tyre.” Romakeve 1:26-27

“A nuk e dini ju se të padrejtët nuk do të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë? Mos u gënjeni: as kurvarët, as idhujtarët, as shkelësit e kurorës, as të zhburrëuarit, as homoseksualët, as vjedhësit, as lakmuesit, as pijanecët, as përqeshësit, as grabitësit nuk do të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë. Dhe të tillë ishit disa nga ju; por u latë, por u shenjtëruat, por u shfajësuat në emër të Zotit Jezus dhe me anë të Frymës së Perëndisë tonë.” 1Korintasve 6:9-11 Me tej, shih: 2Pjetri 2:4-10, Juda 1:7

Çfarë mëson Bibla për martesën?

Martesa është bashkimi civil mes një burri dhe një gruaje.

Testamenti i Vjetër:

“Kështu Perëndia krijoi njeriun simbas shëmbëlltyrës së vet, simbas shëmbëlltyrës së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin e femrën.” Zanafilla 1:27

Dhe njeriu tha: "Kjo së fundi është kocka e kockave të mia dhe mishi i mishit tim. Ajo do të quhet grua sepse është nxjerrë nga burri". Për këtë arsye njeriu do të braktisë babanë dhe nënën e tij dhe do të bashkohet me gruan e tij, dhe do të jenë një mish i vetëm." Zanafilla 2:23-24

Testamenti i Ri:

“Prandaj njeriu do të lërë babanë e vet dhe nënën e vet dhe do të bashkohet me gruan e vet, dhe të dy do të bëhen një mish i vetëm”. Efesianeve 5:31

Çfarë mëson Bibla lidhur me termat ‘Babi’ dhe ‘Mami’ përkundrejt termave ‘Prindi 1’ dhe ‘Prindi 2’?

Testamenti i Vjetër:

“Do të nderosh atin tënd dhe nënën tënde, me qëllim që ditët e tua të jenë të gjata mbi tokën që Zoti, Perëndia yt, po të jep.” Eksodi 20:12

Testamenti i Ri:

“Fëmijë, binduni prindërve tuaj në Zotin, sepse kjo është e drejtë. ``Ndero babanë tënd dhe nënën tënde", ky është urdhërimi i parë me premtim, ``që ti të jesh mirë dhe të jetosh gjatë mbi dhe". Efesianeve 6:1-3

Bibla dhe tradita Judeo-Kristiane, qartësisht, mësojnë se ‘koncepti prind’ përbëhet nga dy persona me gjini të ndryshme; përkatësisht një burrë dhe një grua, që janë babi dhe mami.

Subjekti shprehet se, në esencë komunikimi i tij në media në lidhje me këto tema mbështetet besnikërisht në doktrinën dhe mësimin e Shkrimeve të Shenjta, se komunikimi i tij është doktrinalisht i saktë dhe etikisht korrekt. Sipas tij, a është e mundur që dikush të mendojë drejt mbi çështjet etike dhe sociale që e mendojnë familjen? Religjoni i Krishterë shpall se ka norma absolute për njeriun, martesën, familjen dhe shoqërinë.

Termi “*Egoizëm etik*”, sipas subjektit është përdorur prej tij mbi premisën e kërkesës së këtyre individëve për të ndryshuar nocionet thelbësore të familjes: mami dhe babi dhe ndryshimet që i imponohen kushtetutës, pasi këto kërkesa kërkojnë ndërhyrje dhe ndryshime në Kushtetutën e Shqipërisë. Subjekti thekson se, këto kërkesa nuk drejtohen vetëm për komunitetin LGBTQ+, por kërkojnë t’i imponohen pjesës më të madhe të shoqërisë. Ky egoizëm e zhvesh njeriun nga përgjegjësia të njohë dhe pranojë ligjet morale dhe civile të shoqërisë si rregullatorët, ruajtësit e jetës së njeriut, familjen dhe shoqërinë. Ky egoizëm, Martin Luter King do të thoshte “*e vendos njeriun si kandidat për mosqenien*”, asgjësimin e njeriut, duke e zhvendosur atë nga përgjegjësia të dojë të tjerët, mbylljen e tij brenda një vitrine të padepërtueshme e krijuar nga egoizmi. Në këtë kontekst, egoizmi ndërton një projekt. Kërkesat e parashtruara të këtij projekti, janë ndryshimi në aspektin ligjor të nocioneve ‘Mami’ dhe ‘Babi’ në ‘Prindi 1’ dhe ‘Prindi 2’. Arsyeja pse ka

mbrojtur nocionin ‘Mami’ dhe ‘Babi’ lidhet pazgjidhshmërisht me konceptin doktrinor Judeo-Kristian dhe ruajtjen e vlerave të martesës dhe familjes tradicionale.

Në lidhje me konceptin e “*dehumanizimit të numrit*”, subjekti shprehet se, kjo lidhet me teorinë filozofike të ekzistencializmit funksional, i cili ndihmoi në krijimin e klimës për dehumanizimin e njeriut në Luftën e Dytë botërore, duke krijuar një premisë të fortë për kategorizimin e racave inferiore. Brenda kësaj kategorie u vendosën Hebrenjtë, njerëzit me ngjyrë, njerëzit me aftësi ndryshe dhe natyrisht personat të cilët nuk pranuan t’i nënshtroheshin rregjimit të Rajhut të dytë. Subjekti deklaroi se, ka shprehur se, e gjitha kjo më kujton njerëzit në kampet e përqëndrimit, të cilët rregjistroheshin si një numër në listat e kampeve Naziste, e gjitha kjo ishte pikënisja për të dekonstruktuar strukturat psiko-sociale të individit. Ky zëvendësim nocionesh, nga mami dhe babi në ‘prindi 1’ dhe ‘prindi 2’, inicion zhvendosjen e vlerave personale individuale, të cilat nuk lidhen vetëm në raportin singular të qenies (nuk kemi të bëjmë me një raport të mbyllur të ‘unit’), por në raportin që qenia ndërton në dimensionin e prokrijimit, me qëniet më të dashura tek të cilat derdh jetën e tij çdo ditë. Ky ekzistencializëm funksional, të cilin subjekti shprehet se e ka lidhur me konceptin që ka përdorur në media ‘dehumanizimi i numrit’ mohon esencën e jetës në dimensionin shpirtëror dhe moral. Pazëvendësueshmëria e mamasë dhe babait shpie në pamjaftueshmërinë e çdo alternative apo modeli tjetër prindëror, për të furnizuar foshnjën apo fëmijën me mbështetjen e duhur, e cila është e përcaktuar që në krijim si një e drejtë natyrore e fëmijës të rritet nga një mami dhe babi.

Nga kjo premisë, subjekti deklaron se, ka përshkruar si “*akt kriminal*”, heqjen dhe mohimin e kësaj të drejte natyrore të rritjes së fëmijëve nga dy burra apo dy gra, ndërkohë që kjo e drejtë e mohuar merr mbrojtje prej ligjit dhe kërkesat e LGBTQ+ janë në kundërshtim me ligjet morale të cilave ju referohet dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila shprehet qartë. Sipas subjektit, vetëm kështu mund të kuptohet ajo që ka folur për “*eksperimentin social real*”, i cili propozohet prej përfaqësuesve të LGBTQ+.

Ligji nuk duhet perceptuar si një instrument që një pjese të foshnjeve i jep mundësinë të gëzojnë të drejtën natyrore të rriten me babë dhe nënë, ndërsa një pjese tjetër të fëmijëve, ia heq këtë të drejtë, duke i mundësuar rritjen nga dy burra ose nga dy gra.

Bazuar në nenin 3, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit” dhe nenit 32/4 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, subjekti kërkon:

- të merren të plota dhe jo të cinguara apo të edituara, montazhuara emisionet e sipërcituara, duke pretenduar se citimet në shkresat e Komisionerit janë të cinguara, të nxjerra nga konteksti i diskutimit dhe të montuara, duke nxjerrë çdo fjalë jashtë dhe çdo transkript jashtë çdo kuptimi nga ajo që është thënë. Çdo ndërhyrje në materialin origjinal për ta paraqitur si të vërtetë përbën vepër penale si “shpifja” neni 120 i K.Penal, “mashtrimi”, neni 143 i K.Penal, “Fallsifikimi i dokumentave” neni 186 i K.Penal dhe “Fallsifikimi i dokumentave elektronik” neni 186/a K.Penal;
- të merren dhe të administrohen të plota në kuadër të një hetimi të plotë e të gjithëanshëm administrativ edhe prova të cilat tregojnë mbi qëndrimet e tij në lidhje me këtë temë edhe

ndër vite, si dhe respektin nga ky komunitet ndaj tij si Pastor (Emisioni Zonë e Lirë TV Klan, Emisioni Ndryshe TCH dhe me Rudinën TV Klan, të plotë)⁵.

- Zhvillimin e një seance dëgjimore, duke dëgjuar çdo gjë të thënë në mënyrë të plotë, siç është dhe jo të shkëputur, prerë, montuar dhe manipuluar, në emisionet përkatëse.

Referuar nenit 3, 10/2/6, 17/2, 18/1/2, 22/1, 23/1, 24 të Kushtetutës dhe nenit 9 dhe 10 të KEDNJ, subjekti pretendon se qëndrimi i tij është në kuadër të lirisë së fjalës, e cila është e garantuar nga Kushtetuta dhe po ashtu në kuadër të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë, besimit që ai përfaqëson, të cilat gjithashtu janë të garantuara.

Kryesisht Komisioneri, bazuar në provat e cituara duhet të regjistrojë një ankesë kundër shtetases Xh.K dhe komunitetit që ajo përfaqëson pranë Shoqatës Aleanca LGBT, në kuadër të diskriminimit të fesë dhe ndërgjegjes sipas ligjit nr.10221/2010. Subjekti pretendon gjithashtu se, anëtare dhe OJF të tjera të Komunitetit LGBTQ+ që kanë bërë ankime kundër tij gjatë këtij muaji, rezultojnë së kanë kryer akte diskriminuese ndaj komunitetit që ai përfaqëson dhe kanë fyer besimin e tij. Shkaku është sulmi i vazhdueshëm që ky komunitet ka filluar të kryejë dhe duke shantazhuar këdo që beson në fenë e tij, në ndërgjegjen e tij.

Subjekti thekson se, vetë procesi i hetimit administrativ pa marrë provat e plota dhe pa kryer dëgjuesën publike, si edhe pa kryer një hetim administrativ të plotë e të gjithëanshëm, me aq sa Komisioneri ka dërguar përmes shkresave, rezulton deri në këtë fazë, një proces i montuar dhe i manipuluar dhe si sulm ndaj shoqërisë në përgjithësi dhe familjes tradicionale dhe ligjore në veçanti, ndaj besimit fetar, ndaj lirisë së ndërgjegjes dhe fjalës së lirë, pra i gjithë ankimi është ngritur me akuza të pabazuara në ligj dhe prova kundër lirisë së fjalës, lirisë së besimit dhe parimeve profesionale dhe për të ndëshkuar dhe bërë shembull ndëshkimi dhe shantazhimi të gjithë atyre që kundërshtojnë zëvendësimin e nocioneve ligjore dhe etike NËNË dhe BABA me PRIND 1 dhe PRIND 2.

Liria e fjalës, besimit dhe ndërgjegjes, si të drejta të garantuara nuk mund të cënohen nga ankesa apo shantazhe të tilla, në kuadër të agjendave të caktuara dhe Komisioneri nuk duhet të bëhet palë. Ai shprehet se, nuk ka shkelur asnjë dispozitë të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për më tepër gjithçka ai ka thënë ka qenë në kuadër të pyetjeve të gazetarit në lidhje me qëndrimin Biblik, kishtar, të besimit dhe komunitetit që ai përfaqëson në lidhje me temën për të

⁵ Referencat e emisioneve të cituara në parashtrësën e subjektit janë si më poshtë:

- Emisioni “Zonë e Lirë” në TV KLAN, datë 18 Qershor 2021: <https://www.youtube.com/watch?v=-SZ4CfEQWxg> ; https://www.youtube.com/watch?v=Z_Xy_XdKdo0 ; <https://www.youtube.com/watch?v=dBQZ3dCVTpc>
- Emisioni “Me Rudinën” në TV KLAN, datë 22 Tetor 2020: <https://www.youtube.com/watch?v=XqWPBU3Hf8U>
- Emisioni “ABC e Pasdites” në TV ABC, datë 8 Qershor 2021.
- Emisioni “Shqipëria Live”, datë 9 Qershor 2021, Top Channel: <https://www.youtube.com/watch?v=kQalHW-Le8Y&t=127s>; <https://www.youtube.com/watch?v=gDMbokEudGQ> ; <https://www.youtube.com/watch?v=kQalHW-Le8Y> ; <https://www.youtube.com/watch?v=gDMbokEudGQ>

cilën ka qenë i ftuar. Të gjitha qëndrimet e tija kanë qenë korrekte dhe të garantuara nga neni 24 i Kushtetutës së Shqipërisë dhe neni 9 dhe 10 KEDNJ. Qëndrimet, perifrazimet, shkrimet në Librin e Shenjtë të Biblës, nuk janë qëndrime, thënie diskriminuese. Referuar “ngjalljes së urrejtjes” apo “nxitjes për urrejtje”, referuar legjislacionit tonë shqiptar, subjekti shprehet se, në asnjë moment nuk ka bërë thirrje nxitëse për të ngjallur urrejtje, por përkundrazi, këtë komunitet e do njësoj dhe lutet për ta njësoj në predikimet e tij.

5. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar në të cilën sanksionohet se: “8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes Komisioneri vendosi të realizojë një seancë dëgjimore në datën 02.09.2021, duke ftuar subjektin për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tij.

Njoftimi i seancës dëgjimore u realizua më shkresën nr. 968/5 prot., datë 10.08.2021. Në situatën e shkaktuar si pasojë e pandemisë Covid-19 dhe në respektim të protokollit për masat mbrojtëse anti Covid -19, palëve ju komunikua se lejohej pjesmarrja e vetëm një përfaqësuesi për secilën palë dhe duke kërkuar konfirmimin e pjesmarrjes së vetë palës ose të përfaqësuesve të autorizuar, nëpërmjet kontakteve të komunikuar në njoftimin e seancës dëgjimore.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua me audio.

Në seancën dëgjimore të datës 02.09.2021, ora 10:00, ankuesi u paraqit personalisht, duke pretenduar se, nëpërmjet njoftimit për seancë dëgjimore dhe parashikimit në këtë njoftim se lejohej pjesmarrja e vetëm një përfaqësuesi për secilën palë, atij i ishte cënuar e drejta për të patur një përfaqësues dhe ndihmës ligjor. Gjatë seancës ankuesi pretendoi se, nuk i ishin vënë në dispozicion provat mbi të cilat Komisioneri kishte filluar procedurën administrative dhe se ishte cënuar publiciteti i seancës, pasi nuk kishte pjesmarrje të medias.

Në lidhje me këto pretendime, gjatë seancës dëgjimore ankuesit i’u bë me dije se, nëse kërkesa në lidhje me përfaqësuesin ligjor, do të ishte komunikuar paraprakisht, atëherë seanca mund të shtyhej për një datë tjetër. Nëse subjekti gjendej në pamundësi për t’u mbrojtur vetë, i’u komunikua se, seanca do të shtyhej në një datë tjetër ndërsa, nëse subjekti mund të përfaqësohej vet, seanca mund të vazhdonte. Gjithashtu subjektit i’u komunikua se Komisioneri dispononte CD e emisioneve, ndërsa në lidhje me seancën publike, regjistrimi i seancës në audio i shërben këtij qëllimi dhe se institucioni i Komisionerit në situatën aktuale nuk dispononte kushtet për të patur pjesmarrje të gjerë të medias.

Subjekti deklaroi se materialet që ai kishte vendosur në dispozicion ishin të mjaftueshme për të vazhduar shqyrtimin nga ana e Komisionerit. Subjekti parashtrroi se, në mungesë të

përfaqësuesit ligjor ai ndihej në pozitën që çdo gjë që mund të deklarohej prej tij gjatë seancës do të merrej në dëm të tij, duke theksuar se komunikimi i tij në media është shkëputur nga konteksti.

Nga ana e Komisionerit, subjektit iu theksua se, nëse mos prezenca e përfaqësuesit e vendoste atë në kushtet e pamundësisë për të vazhduar seancën, atëherë diskutimet nuk mund të kalonin në themelin e çështjes. Ankuesit i'u kërkua që të shprehej nëse do të vazhdonte seancën pa praninë e përfaqësuesit apo jo. Ankuesi deklaroi se do të largohej nga seanca dhe në këto kushte seanca u deklarua e përfunduar.

Komisioneri çmon të theksojë se kërkesat e vendosura në njoftimin për seancën dëgjimore, nuk i kanë mohuar ankuesit të drejtën për t'u përfaqësuar me një mbrojtës ligjor, por kanë vendosur vetëm kritere kufizuese në lidhje me numrin e pjesëmarrësve në seancë dëgjimore, kufizime këto të vendosura në kuadër të masave mbrojtëse anti Covid-19. Nëse pala çmon se nuk mund të realizojë vetë mbrojtjen e saj gjatë procedurës administrative, atëherë ajo nuk ka patur asnjë ndalim ose kufizim që në seancë dëgjimore të përfaqësohej nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor të autorizuar.

6. Për të siguruar të drejtën e subjektit që të dëgjohet, Komisioneri vlerësoi që të zhvillojë seancën dëgjimore në një datë tjetër. Seanca dëgjimore u caktua në datën 16.09.2021, ora 10:00 dhe i'u njoftua subjektit me shkresën nr. 1266 prot., datë 08.09.2021. Kjo shkresë i'u komunikua subjektit në rrugë elektronike me e-mail datë 09.09.2021.

Me e-mail datë 15.09.2021, subjekti njoftoi Komisionerin se për shkak të kohës së shkurtër të njoftimit mbi datën për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe për shkak të angazhimeve të përcaktuara kohë më parë në agjendën e tij, të cilat lidhen me ushtrimin e përgjegjësisë klerikale në konferenca brenda dhe jashtë vendit, e kishte të pamundur të ishte i pranishëm në seancën dëgjimore.

Komisioneri vlerëson se, arsyeja e deklaruar nga subjekti për mospjesmarrjen në seancën dëgjimore të datës 16.09.2021, ora 10:00, nuk rezulton e provuar dhe për rrjedhojë mospjesmarrja e ankuesit në seancë dëgjimore konsiderohet e pajustificuar. Për më tepër, Komisioneri konstaton se, ankuesi nuk rezulton të ketë patur ndonjë pengesë për të siguruar pjesmarrjen në seancë dëgjimore nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar dhe se subjekti nuk paraqiti asnjë kërkesë për shtyrjen e kësaj seance.

7. Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, në adresën zyrtare të Komisionerit janë dërguar me email dy shkresa të ardhura nga dy organizata të huaja dhe konkretisht:

- 7.1 Organizata "Pentecostal European Fellowship" (PEF)⁶, nëpërmjet Reverend D.C, drejtues i zyrës në Bruksel të PEF, ka përcjellë me e-mail-in datë 05.07.2021 në adresën zyrtare të Komisionerit, një shkresë, nëpërmjet të cilës kjo organizatë vë në dukje faktin se është

⁶ PEF është një organizatë jo fitimprurëse e 60 kishave në 37 vende europiane, me qendër në Bruksel, Belgjikë.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

informuar mbi procedurën administrative që Komisioneri është duke ndjekur për shqyrtimin e ankesës së sipërcituar, ku pretendohet diskriminim ndaj komunitetit LGBTI, nga ana e A.P. Në shkresë theksohet fakti se, A.P, ka afirmuar pozitat etike të Kishës Protestante Evangjeliste, duke vënë në dukje standardet biblike për një familje dhe shoqëri të shëndetëshme, e drejtë kjo që çdo qytetar ka në të gjitha shoqëritë demokratike. PEF vë në dukje faktin se, fillimi i procedurës administrative nga Komisioneri për A.P ka krijuar shqetësim në rradhët e kësaj organizate, që përfaqëson 6 milion besimtarë të komunitetit kristian në Evropë, duke përfshirë këtu edhe kishat pentekostale (protestante-evangjeliste) në Shqipëri. Në këtë kontekst, organizata kërkon nga Komisioneri, ndërprerjen e menjëhershëm të shqyrtimit të çështjes ndaj A.P.

7.1.1 Në përgjigje të shkresës së mësipërme, Komisioneri, iu drejtua PEF-it, nëpërmjet shkresës nr. 968/3, datë 12.07.2021, ku e informon mbi ankesën nën shqyrtim, si dhe e bën me dije mbi faktin se liria e shprehjes dhe besimit fetar, janë të drejta themelore të njeriut, të cilave ligji u garanton mbrojtje të veçantë nga diskriminimi, në lidhje me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë. Përrjashtimisht, kufizimi i kësaj të drejte, lejohet vetëm kur ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive, e vendosur me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.

7.2 Organizata "Liberty Education Forum" (LEF)⁷, nëpërmjet z. Ch.T.M, Drejtor menaxhues, pranë LEF, ka përcjellë me e-mail datë 31.07.2021 në adresën zyrtare të Komisionerit një shkresë nëpërmjet të cilës kjo organizatë vë në dukje se është informuar në lidhje me procedurat administrative të filluara kundër A.P. Ndër të tjera, kjo organizatë sjellë në vëmendje të Komisionerit, se A.P, në rolin e tij si prijës besimi dhe interpretues i besimit të tij, i jep lirinë për të shprehur mendimin mbi interpretimin e tij fetar në sferën publike. Kjo nuk duhet të interpretohet si "gjuhë e urrejtjes" ose një avokimi për dhunë ose diskriminim të çdo lloji. Sipas LEF, çdo përpjekje për të keqinterpretuar ose për të nxjerrë jashtë kontekstit komentet e A.P, bën më shumë dëm sesa mirë për të çuar përpara kauzën e diversitetit dhe tolerancën.

LEF thekson se, nuk ka një papajtueshmëri të qenësishme midis homoseksualitetit dhe besimeve kryesore të botës. Në shumë kombe konservatore, homoseksualët kanë të njëjtat vlera dhe besime si fqinjët dhe komunitetet e tyre. Sa ka nevojë që barazia të mbrohet me ligj, ka nevojë edhe që të mbrohet po me ligj liria e shprehjes fetare.

LEF vë në dukje se, politika publike efektive, kërkon që të ketë një diskutim të lirë të ideve për të gjetur zgjidhjen më të kujdesshme për të përfituar shoqëria. Lidhur me kundërshtimin publik të A.P ndaj përpjekjeve për të ndryshuar dokumentacionin ligjor duke ndryshuar "Baba" dhe "Nënë" me "Prindi 1" dhe "Prindi 2", si një udhëheqës besimi dhe jo një zyrtar apo politikan i zgjedhur, ai duhet të ketë të drejtën të të sigurojë kontekstin që ai beson se është më i rëndësishëm për traditën e tij të veçantë të besimit. Duke eliminuar të drejtën e tij për të theksuar atë pikë në emrin e "gjuhës së urrejtjes" është në kundërshtim me politikën e mirë publike.

⁷ LEF është një organizatë e cila ka si pjesë të veprimtarisë së saj kufitën kundër stigmës në botë në lidhje me HIV/AIDS dhe komunitetin LGBTI.

LEF thekson se, nuk është dakord me qëndrimin e Pastorit për këtë temë, por sipas saj nuk është kjo çështja. Çështja është se A.P dhe të gjithë qytetarët duhet të kenë të drejtën të shprehën, besimtar ose jo, pa frikë se qeveria do të gjykojë se çfarë është një "mendim" ose "fjalim" i pranueshëm.

6.2.1 Në përgjigje të shkresës së mësipërme, Komisioneri, iu drejtua LEF-it, nëpërmjet shkresës nr. 1267/1, datë 22.09.2021, ku e informon mbi çështjet nën shqyrtim. Ndërsa e informoi se në bazë të ligjit Komisioneri ka detyrimin të marrë në shqyrtim çdo pretendim për diskriminim që paraqitet, organizata u informua në mënyrë të veçantë në lidhje me pasazhet e caktuara nga diskutimi i A.P, në të dy mediat, pasazhe mbi të cilat Komisioneri mori nismën për të filluar ndjekjen kryesisht të çështjes. Komisioneri theksoi se, liria e shprehjes dhe besimit fetar, janë të drejta themelore të njeriut, të cilave ligji u garanton mbrojtje të veçantë nga diskriminimi, në lidhje me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë. Përjashtimisht, kufizimi i kësaj të drejte, lejohet vetëm kur ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive, e vendosur me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të tjerëve.

III. Legjislacioni i zbatueshëm

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 3

Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojtë

Neni 10

2. Shteti është asnjëanës në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike.

6. Bashkësitë fetare janë persona juridikë. Ato kanë pavarësi në administrimin e pasurive të tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve të tyre, për sa nuk çënohen interesat e të tretëve.

Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.

2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.

Neni 22

1. Liria e shprehjes është e garantuar.

Neni 24

1. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar.

2. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve.

3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 9

Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.

2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Neni 10

Liria e shprehjes

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me liçencë.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Neni 14

Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Neni 17

Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një Shteti, grupimi ose individ, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cënimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë.

Protokolli Nr. 12

Neni 1

Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej dy muajsh pas datës në të cilën shtatë Shtete anëtare të Këshillit të Evropës do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur me Protokollin, sipas dispozitave të nenit 8.

2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Neni 2

1. Çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet të respektojë dhe t'u sigurojë të gjithë njerëzve që ndodhen në territorin e tij dhe që varen nga juridiksioni i tij, të drejtat e njohura në këtë Pakt, pa kurrfarë dallimi të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri, lindje ose çdo gjendje tjetër.

Neni 5

1. Asnjë dispozitë e këtij Pakti nuk mund të interpretohet asisoj sikur i njeh një shteti, një grupi ose një personi çfarëdo të drejte për të zhvilluar ndonjë veprimtari ose për të kryer një veprim që synon prishjen e të drejtave dhe lirive të njohura në këtë Pakt ose kufizimin e tyre në një shkallë më të gjerë se sa parashikohet me këtë Pakt.

Neni 18

1. Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim prej tij, si dhe lirinë për të manifestuar fenë apo besimin e vet, qoftë individualisht apo së bashku me të tjerët, si publikisht ashtu edhe privatisht, nëpërmjet kultit dhe kryerjes së riteve, praktikave dhe arsimit.

2. Askush nuk duhet t'i nënshtrohet ndonjë shtrëngimi që do të mund të prekte lirinë e tij për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim të zgjedhur prej tij.

3. Liria e manifestimit të fesë apo të besimit të vet mund të bëhet objekt vetëm i kufizimeve të parapara me ligj dhe që janë të domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë, të rendit e të shëndetit publik, ose të moralit apo të lirive dhe të drejtave themelore të të tjerëve.

4. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të respektojnë lirinë e prindërve dhe, kur është e zbatueshme, të kujdestarëve të ligjshëm për të siguruar edukimin fetar dhe moral të fëmijëve të tyre në përputhje me bindjet e tyre.

Neni 19

1. Secili duhet të ketë të drejtën e opinionit pa ndonjë ndërhyrje.

2. Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij.

3. Ushtimi i lirive të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nënkupton detyra dhe përgjegjësi të posaçme. Për rrjedhojë ai mund t'u nënshtrohet disa kufizimeve të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme: (a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve; (b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.

Neni 20

1. Çdo propagandë në favor të luftës ndalohe me ligj.
2. Çdo thirrje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitjen për diskriminim, armiqësi dhe dhunë ndalohe me ligj.

Neni 26

Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo situatë tjetër.

Ligji Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Neni 3

Përkufizimet

1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

8. “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.

13. “Shqetësim” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues,

poshtëruës a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.

Neni 5

Ndalimi i diskriminimit

1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7

Mbrojtja nga diskriminimi

1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.

Neni 10

Ndërgjegjja dhe feja

1. Ndalohet diskriminimi lidhur me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë, veçanërisht kur ka të bëjë me shprehjen e tyre individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve.

2. Përjashtimi nga kjo dispozitë mund të lejohet vetëm kur ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive. Megjithatë, në çdo rast, lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë mund të vendoset vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Përjashtimi për këtë shkak duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar nevojën për diskriminimin. Në çdo rast lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Akte dhe dokumenta të tjerë në kuadër të Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara

Rekomandimi nr. R(97) 20 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për “Gjuhën e urrejtjes” (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 30 tetor 1997 në takimin e 607-të të Zëvendës Ministrave)

Termi “gjuhë urrejtjeje” do të kuptohet si mbulim i të gjitha formave të shprehjes që përhapin, nxisin, ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera urrejtjeje

të bazuara në intolerancë, duke përfshirë: intolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv dhe etnocentrizmi, diskriminimi dhe armiqësi kundër pakicave, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante.”

Rekomandimi CM/Rek(2010)5 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 31 mars 2010 në takimin e 1081-të të Zëvendës Ministrave)

Komiteti i Ministrave, në përputhje me parashikimin e nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Ministrave,

Duke ditur se lesbiket, homoseksualët, biseksualët dhe transeksualët kanë qenë për shekuj me radhë dhe vazhdojnë ende të jenë objekt homofobie, transfobie dhe formave të tjera të intolerancës dhe diskriminimit edhe brenda familjes së tyre, duke përfshirë kriminalizimin, marxhinalizimin dhe dhunën, për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, dhe duke pranuar se nevojiten masa specifike për të siguruar gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut të këtyre personave;

.....

Duke pasur parasysh se jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (më poshtë “Gjykata”) dhe juridiksione të tjera ndërkombëtare të cilat e konsiderojnë orientimin seksual shkak të ndaluar për diskriminim dhe të cilat kanë kontribuar për çuarjen përpara të mbrojtjes së të drejtave të personave transeksualë;

.....

Duke kujtuar që në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës, çdo dallim në trajtim në mënyrë që të mos jetë diskriminues, duhet të ketë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, pra duhet të ndjekë një qëllim legjitim dhe duhet të përdorë instrumente që janë përpjesëtimisht të arsyeshme me qëllimin e ndjekur;

.....

Duke mbajtur parasysh se as parimi i vlerave kulturore, tradicionale ose fetare, dhe as rregullat e një “kulture dominuese” nuk mund të përdoren si shkaqe për justifikimin e fjalimeve të urrejtjes apo të asnjë forme tjetër diskriminimi, duke përfshirë dhe orientimin seksual ose identitetin gjinor;

.....

U rekomandon shteteve anëtare:

I. E drejta për të jetuar, për siguri dhe mbrojtje nga dhuna

B. “Fjalimet e urrejtjes”

6. Shtetet anëtare marrin masat e nevojshme për të luftuar të gjitha format e shprehjes të cilat mund të kuptohen në mënyrë të arsyeshme se prodhojnë efektin e nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit kundër lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transeksualëve, duke përfshirë median dhe internetin. “Fjalimet e urrejtjes” ndalohen dhe dënohen publikisht. Të gjitha masat respektojnë të drejtën themelore për lirinë e shprehjes në përputhje me nenin 10 të Konventës dhe me jurisprudencën e Gjykatës.

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)

Rekomandimi Nr. 15 i Politikës Së Përgjithshme të ECRI-t “Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”, miratuar më 8 Dhjetor 2015

Duke pasur parasysh që, për qëllimet e këtij Rekomandimi të Politikës së përgjithshme, gjuha e urrejtjes duhet të kuptohet si avokim, promovim apo nxitje në çfarëdo formë të denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi apo grupe personash, si edhe si ngacim, ofendim, stereotipizim, stigmatizim apo kërcënim ndaj personit apo grupi personash dhe justifikimi i të gjitha llojeve të mëparshme të shprehjes mbi shkaqet e "racës"1 , ngjyrës, prejardhjes, përkatësisë kombëtare apo etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë apo besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe karakteristikave të tjera personale apo statusit;

....

Duke pranuar që udhëheqësit politikë, fetarë dhe komunitarë, si dhe personalitete të tjera të jetës publike, kanë një përgjegjësi veçanërisht të rëndësishme në këtë drejtim për shkak të aftësisë për të ndikuar te një publik i gjerë;

B. Përkufizime

Terminologjia

7. Për qëllimet e këtij Rekomandimi, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- a. "avokim" lidhur me denigrimin, urrejtjen apo përgojimin nënkupton mbështetjen e shprehur, të qëllimshme dhe aktive për sjellje dhe qëndrime të tilla lidhur me një grup të caktuar personash;
 - i. "identiteti gjinor" nënkupton e përvojën e brendshme dhe individuale të gjinisë që çdo person ndjen së brendshmi, që mund të mos korrespondojë me gjininë e përcaktuar në lindje, përfshirë ndjesinë personale të trupit (që mund të përfshijë, nëse zgjidhet lirisht, ndryshimin e pamjes apo funksionit trupor me mënyra mjekësore, kirurgjikale, apo të tjera) si dhe forma të tjera të shprehjes së gjinisë, përfshirë veshjen, të folurit dhe manierizmat;
 - g. "denigrim" nënkupton sulmin ndaj kapacitetit, personalitetit apo reputacionit të një apo më shumë personave në lidhje me anëtarësimin e tyre në një grup të caktuar personash;
 - m. "urrejtje" nënkupton gjendjen mendore të karakterizuar nga emocione të forta dhe joracionale mllef, armiqësie dhe përçmimi ndaj grupit të shënjestruar.
 - o. "homofobi" nënkupton paragjykimet, urrejtjen apo frikën nga homoseksualiteti apo nga njerëzit që identifikohen apo perceptohen si biseksualë, homoseksualë, lesbikë apo transgjinorë;
 - q. "nxitje" nënkupton deklaratat për grupe personash të cilat krijojnë rrezik të menjëhershëm diskriminimi, armiqësie apo dhune ndaj personave të grupit/grupeve;
 - u. "stereotipizim negativ" nënkupton një opinion të përgjithshëm sikur një pjesëtar apo pjesëtarët e një grupi personash kanë karakteristika të caktuara, duke i vlerësuar me negativitet, pavarësisht karakteristikave të veçanta të pjesëtarit apo pjesëtarëve fjalë;
 - z. "orientim seksual" nënkupton kapacitetin e kujtdo për tërheqje të thellë emocionale, simpatie dhe seksuale ndaj të tjerëve si dhe marrëdhëniet intime dhe seksuale me individë të një gjinie tjetër apo të së njëjtës gjinie apo të më shumë se një gjinie

bb. "stigmatizim" nënkupton etiketimin e një grupi personash në një mënyrë negative;
cc. "transfobi" nënkupton paragjykimet, urrejtjes apo frikën nga transeksualiteti apo personat transeksualë apo transgjjinorë, bazuar në shprehjen e identitetit të brendshëm gjinor të tyre;
ee. "përgojim" nënkupton kritikën abuzive ndaj një apo shumë personave lidhur me anëtarësinë e tyre në një grup të caktuar personash;
gg. "grupe vulnerabël" nënkupton ato grupe që janë veçanërisht objekt i gjuhës së urrejtjes, që ndryshojnë sipas rrethanave kombëtare por që zakonisht janë azilkërkuesit dhe refugjatët, emigrantët dhe migrantët e tjerë, komuniteti i personave me ngjyrë dhe hebrejve, myslimanët, romët / ciganët, pakica të tjera fetare, historike, etnike dhe gjuhësore, si edhe personat LGBT; në veçanti, përfshin fëmijët dhe të rinjtë që u përkasin grupeve të tilla;

**Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike - Komenti i Përgjithshëm nr. 22:
Neni 18 Liria e Mendimit, ndërgjegjja ose feja, miratuar në sesionin e dyzet e tetë të
Komitetit të të Drejtave të Njeriut, më 30 korrik 1993**

8. Në përputhje me nenin 20, asnjë manifestim i fesë ose besimit nuk mund të përbëjë propagandë për luftë ose mbrojtje të urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë. Siç deklarohet nga Komiteti në komentin e tij të përgjithshëm nr. 11 [19], shtetet palë janë të detyruara të nxjerrin ligje për të ndaluar akte të tilla.

**Progres Raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë 2021, publikuar në 19 tetor 2021.⁸
Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat e njeriut**

Rastet e agresionit fizik ndaj anëtarëve të komunitetit ende ndodhin dhe gjuha e urrejtjes vazhdon, veçanërisht në mediat sociale.

Ndërgjegjësimi publik dhe pranimi i personave LGBTIQ mbetet i ulët, veçanërisht në zonat rurale. Gjuha e urrejtjes dhe gjuha diskriminuese vazhdojnë të jenë problem në media, veçanërisht mediat online, dhe nga politikanët. Dhuna dhe diskriminimi ndaj pjesëtarëve të komunitetit është ende një fenomen shqetësues në vend.

Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (cikli i gjashtë monitorues), miratuar më 7 prill 2020⁹

ECRI rekomandon që autoritetet të marrin frymëzim nga rekomandimi i Politikavetë Përgjithshme Nr.15 i ECRI-t për luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe të dënojnë me forcë dhe publikisht incidente të gjuhës së urrejtjes, veçanërisht kundër personave LGBTI dhe romë. Ata gjithashtu duhet të inkurajojnë figura të tjera publike të dënojnë veprime të tilla dhe të përfshihen në kundërpërgjigje.

⁸ Faqe 34, e variantit në anglisht të Progres Raportit.

⁹ Faqe 17 e Raportit, në variantin e gjuhës shqipe.

Raport “Mbi diskriminimin dhe dhunën ndaj individëve bazuar në orientimin e tyre seksual dhe identitetin gjinor”, të Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, viti 2015¹⁰

Një nga rekomandimet në këtë raport është ndalimi i nxitjes së urrejtjes dhe dhunës për shkaqe të orientimit seksual dhe identitetit gjinor si dhe llogaridhënia e personave përgjegjës për gjuhën e urrejtjes.

IV. Analiza ligjore e fakteve dhe provave.

Referuar informacionit të administruar A.P, i cili rezulton të jetë përfaqësues dhe drejtues i Kishës Ungjilli i Krishtit, ka qenë i ftuar në dy emisione, një emision televiziv dhe një emision radiofonik. Konkretisht, A.P, ka qenë i ftuar dhe ka marrë pjesë në emisionin “Zonë e Lirë”, transmetuar në datën 18.06.2021, në TV Klan dhe në datën 22.06.2021 ka marrë pjesë si i ftuar në emisionin radiofonik “Ndryshe”, i cili transmetohet në Top Albania Radio.

Tema e diskutimit në emisionin “Zonë e Lirë” ka qenë diskutimi në lidhje me nismën e deklaruar nga një aktivist që mbron të drejtat e komunitetit LGBTI¹¹, shtetasit E.I, i cili jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (USA), për të kërkuar shpalljen non grata të personave që kanë përdorur gjuhë urrejtje ndaj këtij komuniteti në Shqipëri.

Më herët, si rezultat i debatit të filluar nga inisiativa e organizatës Stonewall, me qendër në Londër, Angli, në mbrojtje të të drejtave të komunitetit LGBTI, lidhur me përdorimin e terminologjisë “Prindi 1 dhe Prindi 2” në dokumentet zyrtare, si option i mundshëm krahas versionit terminologjik të përdorur deri më sot “Amësi dhe Atësi”, janë zhvilluar disa emisione të tjera televizive si Emisioni “ABC e pasdites” në TV ABC datë 08.06.2021, ku edhe mori fill debati në lidhje me këtë temë. Më pas në televizione të tjera si në emisionin “Shqipëria Live”, të transmetuar në datën 09.06.2021 në televizionin Top Chanel. Në këtë të fundit nga informacioni i administruar rezulton të ketë marrë pjesë edhe A.P.

Komisioneri çmon të saktësojë dhe të sqarojë se, diskutimet dhe deklaratat e bëra në emisionet e tjera nuk janë objekt shqyrtimi në këtë çështje.

Në datë 22.06.2021, disa ditë pas pjesëmarrjes së tij në emisionin “Zonë e Lirë”, A.P, ka marrë pjesë si i ftuar, në emisionin radiofonik “Ndryshe”, në Top Albania Radio. Gjatë këtij emisioni është diskutuar në lidhje me debatin dhe diskutimet në lidhje me daljen e A.P në emisionin “Zonë e Lirë”, opinionin e tij në lidhje me përdorimin e termave “Prindi 1 dhe Prindi 2” si dhe deklaratave të shtetasit E.I për personat homofobë të cilat sipas këtij të fundit kanë në përmbajtje gjuhë urrejtje.

¹⁰ A/HRC/29/23, 4 maj 2015, pika 78.

¹¹ LGBTI është akronim për fjalët: Lezbike, Gej, Biseksual, Transgjinor dhe Interseks.

Në lidhje me pretendimet e subjektit se janë transkriptuar të copëtuara dhe janë nxjerrë nga konteksti i asaj që ai ka thënë në këto emisione duke mos u transkriptuar i plotë i gjithë qëndrimi i tij, Komisioneri saktëson se, pasi ka dëgjuar të gjithë përmbajtjen e emisioneve, ka transkriptuar ato pasazhe dhe pjesë nga diskutimi i bërë nga A.P, të cilat i ka vlerësuar se potencialisht kishin premisa për një gjuhë që shkon në tejkalim të lirisë së shprehjes, ndërsa pjesa e tjetër e diskutimit nuk është vlerësuar si e tillë. Fakti që emisioni nuk është transkriptuar i plotë nuk çënon vërtetësinë e transkriptimit të pjesëve të diskutimit të A.P të pasqyruara në këtë vendim. Asnjë fjalë nga diskutimi i A.P në këto emisione nuk është tjetërsuar dhe ankuesi nuk tregoi në asnjë moment se cilat ishin fjalët nga diskutimet e tij të cilat nuk ishin pasqyruar saktë.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: *“Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme”*. Të dy emisionet ku ka marrë pjesë subjekti, të cilat janë objekt shqyrtimi në këtë çështje, janë bërë publike nëpërmjet transmetimit në media dhe si të tilla deklaratimet e subjektit konsiderohen të njohura publikisht dhe Komisioneri ka administruar regjistrimet e pjesëve respektive të këtyre emisioneve ku janë bërë deklaratimet të cilat janë marrë në shqyrtim nga Komisioneri.

Përpara se të vijojë me analizën e fakteve, Komisioneri thekson se terminologjia e referuar në këtë vendim, i referohet përkufizimit të termave sipas Rekomandimit Nr.15 të ECRI-t.

Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, janë në bazat e shtetit shqiptar. Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i çënojë vetë ato, por ai duhet të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të garantuar mos çënimin e tyre nga privatët, pra shteti duhet të marrë të gjitha masat për t’i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët.

Barazia dhe mosdiskriminimi, janë gur themeli i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë por edhe i të drejtës ndërkombëtare mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat janë ratifikuar nga vendi ynë duke u bërë pjesë të rendit të brendshëm juridik, menjëherë pas Kushtetutës dhe me epërsi ndaj ligjeve kombëtare. Të gjithë personat, pavarësisht nga orientimi i tyre seksual, identiteti gjinor ose karakteristikat e seksit, kanë të drejtën të gëzojnë mbrojtje nga çdo lloj forme diskriminimi.

Liria e shprehjes është një e drejtë Kushtetuese. Liria e shprehjes, përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë dhe për të shprehur ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrje. Liria e mendimit dhe e shprehjes janë thelbësore për çdo shoqëri dhe përbëjnë gurin e themelit për zhvillimin e çdo personi dhe çdo shoqërie të lirë dhe demokratike.

Liria e mendimit, nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi apo ndërhyrje. Asnjë person nuk mund të jetë subjekt i asnjë ndalimi ose kufizimi, për shkak të mendimeve/opinionëve të tij aktuale, të perceptuara apo të supozuara. Të gjitha format e mendimit janë të mbrojtura, duke përfshirë

mendimet politike, shkencore, historike, morale ose të natyrës fetare. Liria e shprehjes, përfshin shprehjen/dhënien dhe marrjen e komunikimeve në çfarëdo lloj forme të ideve dhe mendimeve, të cilat janë të transmetueshme tek të tjerët. Kjo lloj lirie nuk është absolute dhe është subjekt i kufizimeve. Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi.

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë është gjithashtu një e drejtë Kushtuese. Kjo liri përfshin lirinë e mendimit, ndërgjegjes, fesë dhe besimit, si dhe të drejtën për të manifestuar dhe shprehur fenë dhe besimin. Nëse aspekti i parë, pra ai i brendshëm, nuk i nënshtrohet asnjë lloj kufizimi, aspekti i dytë, ai i manifestimit të mendimit, fesë dhe besimit, është subjekt i kufizimeve për mbrojtjen e interesave publikë dhe të drejtave të të tjerëve.

Liria e shprehjes dhe liria për të shprehur/manifestuar fenë dhe besimin, janë subjekt i kufizimeve sipas përcaktimit të nenit 17, të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, kufizimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Referuar KEDNJ, kufizimi i këtyre të drejtave përcaktohet nga neni 9/2 dhe 10/2 si dhe neni 17 të saj.

Këto parashikime shkojnë në të njëjtën linjë edhe me rregullimin dhe nivelin e kufizimeve të zbatueshme për këto të drejta, të parashikuara nga traktatet e të drejtave të njeriut në kuadër të Kombeve të Bashkuara, të cilat vendi ynë i ka ratifikuar, sikurse është Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike. Ky traktat i të drejtave të njeriut rregullon ushtrimin dhe kufizimet e zbatueshme për këto të drejta në nenet 18/3 dhe 19/3 të tij të marra së bashku me nenin 20/2.

Sipas Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), kufizimet e vendosura nga neni 10/2 i KEDNJ, zbatohen jo vetëm për 'informacionet' ose 'idetë' që priten në mënyrë të favorshme ose konsiderohen si jofyese ose si çështje indiferente, por edhe për ato që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë shtetin ose çdo sektor të popullsisë. Të tilla janë kërkesat e atij pluralizmi, tolerance dhe mendjegjerësie pa të cilat nuk ka 'shoqëri demokratike'. Kjo do të thotë, ndër të tjera, se çdo 'formalitet', 'kusht', 'kufizim' ose 'dënim' i vendosur në këtë sferë duhet të jetë në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur". (*Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendimi datë 7 dhjetor 1976, paragrafi 49*).

Toleranca dhe respekti për dinjitet të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si një çështje parimi mund të konsiderohet e nevojshme që në shoqëri të caktuara demokratike të dënohen apo edhe të parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen të bazuar tek mungesa e tolerancës. (*Erbakan kundër Turqisë, vendimi 6 korrik 2006, paragrafi 56*)

Ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, i cili rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shkruese shkaqesh, duke përfshirë orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e seksit, ndalon çdo formë të shprehjes në publik, me çdo mjet, të promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes për këto shkaqe. Këto shprehje, përbëjnë “gjuhë urrejtje”, e cila sipas ligjit përbën një nga format e shfaqjes së diskriminimit.

Kufizimi i gjuhës së urrejtjes duket se kërkon një pajtim të dy grupeve të vlerave: kërkesat e shoqërisë demokratike për të lejuar debat të hapur dhe autonomi dhe zhvillim individual me detyrimin gjithashtu bindës për të parandaluar sulmet ndaj komuniteteve vulnerabël dhe për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë dhe jodiskriminuese të të gjithë individëve në jetën publike. Në këtë kontekst çështja thelbësore që shtrohet në çështjen objekt shqyrtimi, është pesha respektive që ka liria e shprehjes si dhe liria e fesë dhe besimit në raport, me të drejtën për të jetuar të lirë nga diskriminimi dhe për të gëzuar respekt të barabartë, të të gjithë personave pavarësisht orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor apo karakteristikave të seksit.

Sa më sipër rezulton se, kufizimi i lirisë së shprehjes dhe lirisë së shprehjes së fesë dhe besimit, është një kërkesë e imponuar nga parashikimi që bëhet në ligjin “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, i cili sanksionon se gjuha e urrejtjes përbën një nga format e shfaqjes së diskriminimit dhe se çdo formë e shprehjes e ushtruar në kundërshtim me këtë ligj është e ndaluar.

Gjithashtu, rezulton plotësisht e qartë se, kufizimi i lirisë së shprehjes dhe lirisë së shprehjes së fesë dhe besimit, të pretenduar nga subjekti, kërkohet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, që në rastin konkret është sigurimi i barazisë dhe mbrojtja nga diskriminimi i personave për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit, shkaqe këto që garantojnë kuadrin mbrojtës të komunitetit të personave LGBTI.

Në këtë mënyrë përmbushen dy kushtet mbi bazën e të cilave mund të kufizohen si e drejta e shprehjes, ashtu edhe ajo e fesë dhe besimit, kufizimi është vendosur bazuar në ligjin “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar dhe për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve në rastin konkret për mbrojtjen nga diskriminimi të personave që i përkasin komunitetit LGBTI. Ajo që mbetet të vlerësohet është domosdoshmëria dhe proporcionaliteti.

Neni 3/8 i ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ndalon gjuhën e urrejtjes, në çdo formë të shprehjes në publik dhe me çdo mjet. Komisioneri vlerëson se, në rastin objekt shqyrtimi shprehja është realizuar nëpërmjet fjalëve dhe në mënyrë publike, pasi gjuha në shqyrtim e përdorur nga A.P është bërë në një platformë publike, siç është media, dhe se media audiovizive dhe ajo radfonike, përfshihet në mjetet e përhapjes së gjuhës së urrejtjes.

Gjatë shyrimit të çështjes, A.P, prapësoi se, të gjitha qëndrimet dhe perifrazimet e tij në lidhje me temat e trajtuara në emisionet ku ai ka marrë pjesë janë korrekte etike dhe bazohen në traditën judeo-kristiane dhe Librin e Shenjtë të Biblës dhe se të gjitha qëndrimet e tij kanë qenë korrekte dhe të garantuara nga neni 24 i Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenet 9 e 10, të KEDNJ-së.

Komisioneri konstaton se, shumë prej argumenteve të paraqitura nga A.P, jepen për të justifikuar dhe për të argumentuar qëndrimin e tij kundër propozimit të bërë në lidhje me përdorimin e terminologjisë “Prindi 1 dhe Prindi 2” në dokumentet zyrtare, si opsion i mundshëm krahas versionit terminologjik të përdorur deri më sot “Amësi dhe Atësi”. Në këtë kontekst, Komisioneri çmon të sqarojë dhe të saktësojë se, objekt shqyrtimi i kësaj çështje nuk është vlerësimi i këtij propozimi apo i kërkesave të komunitetit LGBTI, por gjuha e përdorur nga A.P gjatë shprehjes së mendimeve, opinioneve apo qëndrimit, qoftë edhe në kuadër të lirisë së ndërgjegjes, fesë dhe besimit të tij, në kuadër të këtij debati. Sikurse është theksuar edhe më sipër liria e pasjes së mendimeve ose opinioneve dhe liria e ndërgjegjes fesë dhe besimit, janë të drejta të cilat nuk mund të kufizohen, ndërsa shprehja ose manifestimi i tyre është objekt i kufizimeve sipas përcaktimeve të mësipërme.

A.P gjithashtu prapësoi se, ai nuk kishte bërë në asnjë moment thirrje nxitëse për të ngjallur urrejtje dhe se çdo gjë që ai ka shprehur bazohet në besimin e tij. Në lidhje me këtë pretendim, Komisioneri thekson se, sikurse rezulton edhe nga përkufizimi i gjuhës së urrejtjes dhe nxitja e urrejtjes mund të rezultojë edhe nga deklaratat që shqetësojnë, fyejnë, stigmatizojnë ose përbëjnë një stereotip negativ dhe që bazohen në një nga shkaqet e mbrojtura duke përfshirë edhe shkaqet e orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikat e seksit. Në këtë kontekst, GJEDNJ në çështjen Féret kundër Belgjikës (*Féret kundër Belgjikës, Kërkesa nr. 15615/07, 16 korrik 2009*) është shprehur se “..... nxitja e urrejtjes nuk nënkupton domosdoshmërisht thirrje për kryerjen e akteve të dhunës apo ndonjë akti tjetër të paligjshëm. Sulmet ndaj grupeve të veçanta të popullsisë të kryera nëpërmjet fyerjes, talljes apo shpifjes, mund të jenë të mjaftueshme për autoritetet për të përlligjur trajtim të menjëhershëm dhe efikas kundër shprehjeve raciste, përballë lirisë së shprehjes të ushtruar në mënyrë të papërgjegjshme.....”

Gjuha e urrejtjes konsiderohet e tillë edhe kur efekti që prodhon apo krijon pritshmërinë se mund të nxisë drejt kryerjes së akteve të dhunës, frikësimit armiqësisë apo diskriminimit.

Për të vlerësuar nëse ekziston rreziku që aktet e promovuara ose të nxitura nga gjuha e urrejtjes të ndodhin, Komisioneri ka marrë në konsideratë rrethanat e mëposhtme, në përputhje me frymën e Rekomandimit Nr. 15 të ECRI-t.

Duke ju referuar përmbajtjes së diskutimeve, gjuhës dhe fjalëve të përdorura nga A.P, rezulton se personat LGBTI portretizohen si persona të cilët janë një kërcënim për traditën apo vlerat shoqërisë. Këta persona, sipas referimeve të bëra nga subjekti konsiderohen si persona që çenojnë familjen tradicionale, që kërkesat e tyre janë antivlera pasi synojnë mungesë respekti ndaj

prindërve duke propozuar heqjen e fjalëve “mami” dhe “babi”. Ai përdor fjalën “*devijancë*” për faktin e të qenit gej apo fjalët se “*Nuk ka akt më të shëmtuar dhe nuk ka akt më skandaloz*” apo “*Nuk ka çnderim më të madh se sa të heqësh nocionin nënë dhe t’i vendosësh një numër*” dhe “*dekonstruksion të nocioneve dhe vlerave*” duke ju referuar propozimit lidhur me opsionin e regjistrimit të fëmijëve nga çiftet e këtij komuniteti. Deklarata e A.P se ai është kundër gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI, nuk gjen asnjë mbështetje në gjuhën e përdorur gjatë diskutimeve të tij në këto emisione.

Referuar gjuhës së përdorur nga A.P, Komisioneri konstaton se personat LGBT gjithashtu portretizohen si persona të cilët me kërkesat e tyre çënojnë interesat dhe të drejtat e fëmijëve, duke vendosur një lidhje të drejtpërdrejtë të këtyre kërkesave dhe cilësimit të tyre si “akte kriminale”. Në këtë mënyrë personat LGBTI portretizohen si persona të cilët paraqesin rrezik për këtë kategori të veçantë, siç janë fëmijët, që gëzojnë një mbrojtje të posaçme, duke shprehur një gjë të pavërtetë, se kërkesa e tyre përbën “akt kriminal”. Cilësimi i kërkesave të komunitetit LGBTI si “akte kriminale”, ndërkohë që një gjë e tillë është e pabazuar, bën që personat e këtij komuniteti të perceptohen nga publiku si “kriminelë” për sa kohë që kërkesat e tyre konsiderohet si “akt kriminal”.

Duke dalë përtej temës së regjistrimit të fëmijëve dhe opsionit të përdorimit të termave “prindi 1” dhe “prindi 2”, A.P, gjatë diskutimit të tij trajton edhe çështje të tjera që lidhen me komunitetin LGBTI, si martesë apo çështjet e birësimit. Sipas subjektit pretendimet e personave LGBTI duhet të shikohen si kundra moralit të shoqërisë duke u shprehur “*Me legalizimin e martesave hiqet steka morale.*” apo duke bërë një lidhje dhe krahasime me fenomene apo sjellje të cilat nuk janë të lejuara në shoqërinë tonë si poligamia apo martesë me kafshë duke u shprehur: “*Që do të thotë që çdo njeri mund të vijë dhe të kërkojë martesën dhe me një kafshë, mund të kërkojë edhe martesën treshe, katërshe....Nuk ka më kufi*”

Zoofilia, njihet si një lloj parafilie, e karakterizuar nga fantazi të përsëritura të zgjimit seksual, dëshirave seksuale ose sjellje që përfshijnë tërheqjen erotike të një personi ndaj një kafshe.¹² “*Bestialiteti*”¹³ është një lloj parafilie e karakterizuar nga kryerja e marrëdhënies/aktit seksual midis një personi dhe një kafshe¹⁴. “Zoofilia” dhe “Bestialiteti”, janë terma që shpesh përdoren në mënyrë të ndërsjellë, por bëhet një dallim midis tërheqjes (zoofilia) dhe aktit (bestialitetit). Në shumë vende “Bestialiteti” konsiderohet i paligjshëm, bazuar në legjislacionin për mbrojtjen e kafshëve ose ligjeve që kanë të bëjnë me krimet seksuale, ku sjellje të caktuara seksuale janë të dënueshme ose të ashtuquajtura krime kundër natyrës ose akte kundra natyrës/jo të natyrshme, ku forma të sjelljes seksuale që nuk konsiderohen të natyrshme apo të denja, përbëjnë vepra të dënueshme ligjrisht.

12 A Dictionary of Psychology (4 ed.), Andrew M. Colman, Oxford University Press, 2015 :

<https://www.oxfordreference.com/view/10.1093/acref/9780199534067.001.0001/acref-9780199534067-e-977>

¹³ Termi në gjuhën angleze “Bestiality”.

¹⁴ Si më sipër.

Që prej janarit 2021, është në fuqi “Klasifikimi statistikor ndërkombëtar i sëmundjeve dhe problemeve shëndetësore të lidhura (ICD-11)”¹⁵ i cili miratohet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). Sipas këtij klasifikimi, “Parafilia”, parashikohet si çrregullim në kuadër të “06 Çrregullime mendore, të sjelljes ose neurozhvillimore”. Sipas përshkrimit që jepet në këtë klasifikim të OBSH-së : “Çrregullimet parafilike karakterizohen nga modele të vazhdueshme dhe intensive të zgjimit seksual atipik, të manifestuara nga mendimet, fantazitë, nxitjet ose sjelljet seksuale, fokusi i të cilave përfshin të tjerët, moshën ose statusin e të cilëve i bënë ata të pavullnetshëm ose të paafte për të dhënë pëlqimin dhe mbi të cilat personi ka vepruar ose nga të cilat ai ose ajo është dukshëm i shqetësuar. Çrregullimet parafilike mund të përfshijnë modele eksitimi që përfshijnë sjellje të vetmuar ose individë që pranojnë vetëm kur këto shoqërohen me shqetësim të theksuar që nuk është thjesht rezultat i refuzimit ose frikës së refuzimit të modelit të eksitimit nga të tjerët ose me rrezik të konsiderueshëm lëndimi ose vdekjeje.”¹⁶

Sikurse rezulton, nuk vendoset ndonjë lidhje midis këtyre termave, dukurive apo sjellje si “zoofilia” apo “parafilia” dhe homoseksualitetit. Gjithashtu, nuk rezulton që të ketë një lidhje të drejtpërdrejtë midis vendeve që kanë legalizuar martesat midis personave të të njëjtës gjini, apo që njohin bashkëjetesën e çifteve homoseksuale ose birësimin e fëmijëve nga persona që i përkasin komunitetit LGBTI dhe legjitimitetit të zoofilisë ose martesës me kafshë.

Sipas raportit të publikuar nga ILGA Word¹⁷ në dhjetor të 2020 “Përmbledhje e Përditësuar e Legjislacionit Global”¹⁸ i cili jep një pasqyrim të situatës dhe mbrojtjes ligjore në mbarë botën, të personave LGBT, rezulton se:

- gjithsej 28 shtete anëtare të OKB-së lejojnë martesat të të njëjtit seks që nga dhjetori 2020, me 1 shtet jo-anëtar të OKB -së shtesë dhe 30 territore jo të pavarura që kanë gjithashtu barazi martesë”
- gjithsej 34 shtete anëtare të OKB-së kanë njohje ligjore të partneriteteve të të njëjtit seks, me 1 shtet jo-anëtar të OKB-së shtesë dhe 20 territore jo të pavarura që gjithashtu njohin bashkime të tilla në shkallë të ndryshme.
- që nga dhjetori 2020, ka 28 shtetet anëtare të OKB-së dhe 25 juridiksione jo të pavarura, të cilat njohin birësimin e përbashkët nga çiftet e të njëjtit seks, dhe 31 shtete anëtare të OKB-së, 1 shtet jo anëtar i OKB-së, dhe 25 juridiksione jo të pavarura të cilat njohin birësimin nga prindi i dytë.

Sipas hartës së përgatitur nga ILGA Word¹⁹, bazuar në të dhënat e mbledhura nga raporti i mësipërm, nuk rezulton ndonjë lidhje midis poligamisë dhe vendeve të cilat kanë njohur martesat ose partneritet midis personave të të njëjtit seks. Përkundrazi, sipas informacionit të përditësuar

¹⁵ <https://www.who.int/standards/classifications/classification-of-diseases>

¹⁶ <https://icd.who.int/browse11/l-m/en#/http://id.who.int/icd/entity/2110604642>

¹⁷ ILGA është një organizatë ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI, të cilës është akredituar statusi si organizatë konsultuese në kuadër të Kombeve të Bashkuara.

¹⁸ https://ilga.org/downloads/ILGA_World_State_Sponsored_Homophobia_report_global_legislation_overview_update_December_2020.pdf

¹⁹ https://ilga.org/sites/default/files/downloads/ENG_ILGA_World_map_sexual_orientation_laws_dec2020.png

të publikuar në këtë raport rezulton se, midis vendeve të cilat ndalojnë martesat ose parteritetet e personave të të njëjtit seks, janë më tepër ato vende në të cilat poligamia është e lejuar, siç janë Afganistani, Pakistani, Irani, Emiratet e Bashkuara Arabe, Algjeria etj.

Debati dhe diskutimi për çështje të ndryshme është i nevojshëm veçanërisht për tema apo çështje sensitive, që janë në interes të opinionit të gjerë. Diskutime mbi informacione jo të bazuara shpesh çojnë në krijimin e paragjykimeve dhe stigmatizimin e personave për shkak të orientimit seksual identitetit gjinor apo karakteristikave të seksit. Ligjërime apo fjalime të tilla, të cilat i portretizojnë personat LGBT si kërcënim për shoqërinë apo duke i cilësuar si akte kriminale kërkesat e tyre, stimulojnë frikën, nxisin qëndrime negative, nxisin diskriminimin dhe për këtë arsye ato janë në kundërshtim me ligjin. Gjuha e përdorur nga A.P stigmatizon personat e komunitetit LGBTI duke i etiketuar ata në një mënyrë negative dhe me attribute të pavërteta.

Gjuha e përdorur nga A.P, është përcjellë në një kontekst kur debati i lindur si pasojë e diskutimit të propozimit në lidhje me opsionin e përdorimit të termave “prindi 1” dhe “prindi 2” për të mundësuar regjistrimin e fëmijëve të çifteve që i përkasin komunitetit LGBTI, ka shkaktuar tensione të rënda në shoqëri. Si pasojë e këtij debati, nga aktivistë të komunitetit LGBTI janë raportuar kërcënime të shumta në rrjetet sociale dhe se një anëtar i këtij komuniteti është dhunuar fizikisht. Shqetësimet për këto akte janë përcjellë pranë Komisionerit nga aktivistë të këtij komuniteti, por edhe nga Njësia për orientimin seksual dhe identitetin gjinor pranë Këshillit të Evropës, në një deklaratë të bërë në datën 17.06.2021, në faqen zyrtare të kësaj njësie në rrjetin social Facebook.²⁰ Komisioneri ka konstatuar se gjuha e përdorur ka nxitur komente nga persona të ndryshëm në platformat sociale si “Youtube”, “Facebook” apo “Instagram”, komente të cilat janë fyese, denigruese dhe në disa raste edhe janë përdorur fjalë të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë përbëjnë thirrje për akte dhune. Gjuha e përdorur dhe e shpërndarë në një mjedis shoqëror ku homofobia dhe transfobia janë të theksuara dhe paraqesin një fenomen shqetësues, shton mundësinë që të nxiten akte frikësimi, armiqësimi apo diskriminimi ndaj personave LGBTI që drejtohen në ratin konkret.

Duke qenë një përfaqësues dhe udhëheqës fetar, A.P ka aftësi për të ndikuar tek një publik i gjerë. Në mënyrë të veçantë rezulton se A.P është një person aktiv në jetën publike nëpërmjet prezencës së tij në media, sikurse deklaroi edhe vetë në parashtrimet e tij. Duke u bazuar tek statusi i tij, A.P mban detyrime të shtuara, në raport me persona të tjerë të cilët nuk kanë një profil publik, për të treguar një vigjilencë të shtuar në lidhje me gjuhën që përdor gjatë ushtrimit të lirisë së shprehjes dhe lirisë së fesë dhe besimit. Për shkak të statusit dhe ndikimit që ka tek të tjerët, ai duhet të tregojë një përgjegjshmëri më të madhe në lidhje me gjuhën e përdorur për të transmetuar qëndrimet, mendimet apo mesazhet, qofshin këto edhe të bazuara në fenë apo besimin të cilit ai i përket.

Në mënyrë të përsëritur në të dy emisionet A.P ka përdorur të njëjtën gjuhë duke etiketuar personat LGBTI në një mënyrë negative, pasi me kërkesat e tyre ata janë kërcënim për shoqërinë

²⁰ <https://www.facebook.com/councilofeuropesogiunit/posts/3173480006257120>

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

apo duke i etiketuar se me kërkesat e tyre janë duke konsumuar akte kriminale, si dhe duke i krahasuar në mënyrë të pavërtetë me zoofilinë apo poligaminë, të cilat në asnjë rast nuk rezultojnë të lidhura.

Në çështjen në fjalë, Komisioneri mban parasysh edhe mjetin nëpërmjet të cilit janë përhapur deklaratat. Komisioneri vlerëson se, përhapja e ligjëratave të tilla nëpërmjet medias audiovizive dhe radiofonike është shumë më e fuqishme dhe arrin te një publik shumë të gjerë. Të dy emisionet nëpërmjet të cilave është shprehur gjuha e urrejtjes janë media që kanë një shtrirje kombëtare.

Komisioneri vlerëson se, gjuha e përdorur nga subjekti krijon në radhët e publikut dhe veçanërisht të atyre personave që nuk janë të mirë informuar, ndjenja keqkuptimi, refuzimi, e tek disa ndjenja urrejtje ndaj komunitetit LGBT. Në çështjen Féret kundër Belgjikës²¹, GJEDNJ, ka mbajtur qëndrimin se: *“.....një ligjëratë e tillë në mënyrë të paevitueshme do krijojë mes publikut – e veçanërisht mes atyre anëtarëve të publikut që nuk janë të mirinformuar – ndjenja keqkuptimi, madje refuzimi e te disa, edhe urrejtje*”.

Edhe pse deklaratat e bëra nga A.P, nuk drejtohen kundër individëve të caktuar, anëtarët e komunitetit LGBTI, portretizohen dhe etiketohen si modele negative vetëm për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit. Këto deklarata edhe pse nuk janë një kërcënim i drejtpërdrejtë ndaj një personi të caktuar, mund të kuptohen si deklarata që nxisin urrejtje.

Duke ju rikthyer çështjes Féret kundër Belgjikës, GJEDNJ, ka mbajtur qëndrimin se: *“.....ndonëse deklaratat e ankuesit nuk drejtoheshin kundër individëve të caktuar – anëtarë të komuniteteve të emigrantëve/refugjatëve, ata i shihnin ata kolektivisht nën një dritë negative dhe i portretizonin si kontingjent krimi dhe oportunist të prirur për të përfituar nga rezidenca e tyre në Belgjikë”* Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, duke referuar në konkluzionet e mësipërme të çështjes Féret kundër Belgjikës, thekson në çështjen Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë²², se: *“diskriminimi në bazë të orientimit seksual është po aq serioz sa diskriminimi për shkak të “racës, origjinës, ose ngjyrës”.*

Institucionet fetare gëzojnë autonomi në administrimin e çështjeve të tyre dhe mund të kenë opinionë të ndryshme në lidhje me çështjet e orientimit seksual, identitetit gjinor apo karakteristikave të seksit, por në asnjë rrethanë ato nuk duhet të nxisin dhunë apo urrejtje. Në këtë kontekst shprehja e lirisë së fesë dhe besimit e dikujt nuk mund të çenojë të tjerët për të patur një jetë të lirë nga urrejtja dhe diskriminimi.

²¹ Féret kundër Belgjikës, Kërkesa nr. 15615/07, 16 korrik 2009

²² GJEDNJ, Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë, nr. 1813/07, datë 09 shkurt 2012

Personat e komunitetit LGBTI kanë qenë dhe vazhdojnë ende të jenë subjekte të homofobisë, transfobisë dhe formave të tjera të intolerancës dhe diskriminimit. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se për shkak të vulnerabilitetit të këtij grupimi është e nevojshme që të ndërmerren masa të menjëhershme për të ndaluar çdo përdorim të gjuhës së urrejtjes dhe për të siguruar gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut të këtyre personave.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në çështjen e Firmës Feryn (*Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding kundër Firmës Feryn NV, C-54/07, 10 korrik 2008*), ka mbajtur qëndrimin dhe ka pranuar se diskriminimi mund të shfaqet edhe në ato raste kur nuk mund të identifikohet një viktimë. Komisioneri vlerëson se në çështjen në fjalë, gjuha e përdorur përcjell një gjuhë urrejtje të pajustificuar, saqë edhe në mungesë të identifikimit të një individi konkret si viktimë diskriminimi, mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese, do të cënonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

Përfundimisht, duke marrë në konsideratë të gjitha aspektet e analizuara më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, gjuha e përdorur nga A.P, përbën gjuhë urrejtje kundër personave që i përkasin komunitetit LGBTI, për shkak të orientimit seksual identitetit gjinor dhe karakteristikat e seksit. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura nga A.P janë në tejkallim të lirisë së shprehjes dhe lirisë së shprehjes së fesë dhe besimit dhe si të tilla ato nuk mund të gëzojë mbrojtje nga nenet 22 dhe 24 të Kushtetutës, nenet 9 dhe 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe neneve 18 dhe 19 të Paktit ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Për të gjitha arsyet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se kufizimi i gjuhës së urrejtjes është i domosdoshëm dhe proporcional.

Në përfundim, Komisioneri sjell në vëmendje deklaratën e një grupi ekspertësh ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, në kuadër të Kombeve të Bashkuara, për Ditën Ndërkombëtare kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë, në datë 17 maj 2021²³, deklaratë të cilës i është bashkuar edhe Komisionerja për të Drejtat e Njeriut e Këshillit të Evropës znj. Dunja Mijatovic.

Në këtë deklaratë u bëhet thirrje shteteve, institucioneve të bazuara në besim, udhëheqësve fetarë dhe palëve të tjera të interesit që të marrin në konsideratë ndikimin negativ të narrativave përjashtuese ose stigmatizuese mbi dhunën dhe diskriminimin ndaj lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transgjinorëve. Ndër të tjera në këtë deklaratë theksohet gjithashtu se: “ *Traditat e besimit mësojnë nevojën për të dëgjuar ata që janë të heshtur dhe për të ngritur lart ata që janë të shtypur. Ato na kërkojnë të gjejmë gjuhën e përbashkët në përvojën njerëzore. Ato nxisin të përqafojnë të tjerët, veçanërisht ata që janë të ndryshëm. Besimi motivon shumë njerëz që të punojnë pa u lodhur për të mirën e përbashkët duke gjetur qëllimin e jetës dhe duke dhënë kontribute unike për botën. Ato frymëzojnë shumë njerëz që të bëjnë zgjedhjet që do të lejojnë arritjen e potencialit të tyre të plotë dhe të jenë vetja e tyre më autentike, në mënyrë që të mund të udhëheqin me dashuri, guxim dhe mirësi. Në këtë kuptim, një perspektivë gjithëpërfshirëse e besimit mbi seksualitetin dhe gjininë mund të krijojë një hapësirë thellësisht kuptimplotë*

²³Shiko: <https://www.ohchr.org/en/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=27091&LangID=E>

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodë Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

mikpritjeje dhe pranimi, ku njerëzit mund të lulëzojnë së bashku, të shprehen në mënyrë autentike dhe të ndihen më afër njëri-tjetrit. Ne besojmë se kuadri ndërkombëtar i të drejtave të njeriut dhe parimet humaniste në thelb të çdo feje kanë një rol të ndërvarur: të ruajnë dhe promovojnë dinjitetin e natyrshëm dhe të barabartë të çdo qenie njerëzore, të udhëheqin njerëzit dhe shoqëritë në kërkimin e tyre për lumturi dhe të ndërtojnë një botë ku të gjithë mund të jetojnë të lirë dhe të barabartë. Kjo është arsyeja pse sot ne u bëjmë thirrje të gjithë njerëzve të besimeve dhe udhëheqësve fetarë që të përvetësojnë dhe përqafojnë ligjërimin publik që është i respektueshëm dhe i dhembshur dhe të përmbahen nga riprodhimi i narrativave që përjetësojnë stigmën, justifikojnë diskriminimin dhe nxisin dhunën.”

Në nenin 33, pika 10, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa mbështetur në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”. Ligji nuk ka përcaktuar masat që duhen ndërmarrë për rregullimin e situatës diskriminuese, atribut ky që është lënë në diskrecionin e Komisionerit. Në këtë kontekst, Komisioneri vendos rast pas rasti, se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të individëve që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese duhet të jetë detyrimi i A.P që të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër personave LGBTI dhe të evitohet në të ardhmen përdorimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI :

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e “gjuhës së urrejtjes” të personave që i përkasin komunitetit LGBTI, për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit, si pasojë e gjuhës së përdorur nga A.P në emisionin Zonë e Lirë, transmetuar në datë 18.06.2021 në TV Klan dhe emisionin “Ndryshe” transmetuar në datën 22.06.2021 në Top Albania Radio.
2. Në referim të pikës 1 të këtij vendimi A.P, në cilësinë e personit i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër personave LGBTI dhe të evitohet në të ardhmen përdorimin e saj.

3. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, A.P, duhet të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Orientimit seksual, identitetit gjinor, karakteristikat e seksit
Lloji i vendimit: Diskriminim
Forma: Gjuhë urrejtje